[Shqiptarja.com]

E hënë 4 Gusht 2025 - Përditësimi i fundit 23:27

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE ÇMËLIT PUNËS SPECIALE LAJME TË MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKUL RECETA HOROSKOPI DOLLE FOTOGALERI VIDEOGALERI PRÉ E ZEZË SONDAZHE

POP-5 Lajme nga botës me 5 minutësh me lexim

1 "Turizmi në Shqipëri bëjnë si ku dëmtojë", DEAGON Alin Prengaj me mesazhe nga botë me at nga mashtrimet me ai e mos

2 Luft Deroshi: Trendimi Kosovë Zvicrë duhet që njerëzit urdha, një problematikë

3 U vrëshkatua sot në Vaun e Dejës, 65-vjeçari kishte vrarë kushëririn me fq burg, u lirua dy vite me paré

4 Kërc jasë 5 shoqërë e kanabisit gjë do ke kanë rrj jasë plot njerëzit.

5 Filmuan dejen e vuftës me brisk çë po ngjet, pas bombardimit nga ushtria izraelite, ka vetëm emotion dhe gjithë 2 M fëmira e FOTO/VIDEO

Vrasësi

# Shkodër/ Ish-polici ekzekutohet në Vaun e Dejës, u gjet i vdekur në rrugë! I dënuar më parë për vrasjen e kushëririt, motiv dyshohet hakmarrja (VIDEO)

*Ngjarja mëth orës 21.00, në fshatin Papçam. Frrok Lleshaj po ecte në rrugë kur u qëllua për vdekje me pistoletë, një kalimtar gjetë trupin. Është 65 vjeç dhe i dënuar më parë për vrasjen e Dodë Lleshajt me 25 vite burg, u lirua më 2023. U largua nga radhët më 1994.* ***Familja e kishte braktisur pas daljes nga burgu, mereraj me bleqtorë***

- report Tv siguron FOTO-n e viktimës! Ish-polic tre dekada më parë, u largua më 1994!
- U ekzekutua sot në Vaun e Dejës, 65-vjeçari kishte vrarë kushëririn! Më 2006 u dënua me 25 vite burg, u lirua dy vite më parë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Ergys Kavaja
4 Gusht, 21:34 | Përditësimi: 4 Gusht, 23:08

Share

**Vau i Dejës**- Një vrasje me armë zjarri ka ndodhur orët e vona të mbrëmjes së sotme, në Vaun e Dejës në Shkodër.

Ngjarja e rëndë u raportua mëth orës 21.00, në fshatin Papçam dhe policia e konfirmoi gjetjen e një trupi të pajetë, i cili dyshohej se ishte qëlluar me armë zjarri pistoletë, shumë pranë banesës së tij.

Viktima është identifikuar si Frrok Lleshaj, 65 vjeç, ish-efektiv i Policisë deri në vitin 1994. Forca të shumta policie shkuan në vendngjarje. Lleshaj mësohet se ka qenë më parë i dënuar për krimin e vrasjes së kushëririt të tij Dodë Lleshaj tre dekada më parë, ndaj edhe pista kryesore e hetimit mbetet ajo e një gjakmarrjeje të mundshme.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
**Pukë, shpëtohen 2 turistë holandeze në Majën e Murgës! Emanuel Pjetri apelon: Mos mermi malet pa udherrëfyes**

Gjykata e Shkodrës e kishte dënuar me 25 vite burgim më vitin 2006, izolim që e kishte përfunduar dy vite më parë, kur ishte liruar nga qelia.

> *"Në Vau i Dejës, në rrugë është gjetur pa shenja jete shtetasi F. Ll., 65 vjeç, i cili dyshohet se është vrarë me armë zjarri. Shërbimet e Policisë ndodhen në vendngjarje", tha policia vendore.*

Pas daljes nga burgu, 65-vjeçari ishte braktisur nga familja e tij, gruaja dhe fëmijët. Lleshaj jetonte i vetëm dhe merrej me bleqtorë.

Paraprakisht bëhet me dije se 65-vjeçari ka qenë duke ecur në rrugët e fshatit Papçam mbrëmjen e sotme kur është qëlluar me armë zjarri dhe shkak dyshohet hakmarrja. Trupi i tij u gjet nga një kalimtar i rastësishëm, që informoi menjëherë policinë.

Ndërkohë, është ngritur një grup i posaçëm hetimor, i cili nën drejtimin e Prokurorisë Shkodër, po punon për sqarimin e rrethanave, dokumentimin ligjor, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit apo autorëve. Po verifikohet edhe aktiviteti i viktimës pas daljes nga burgu dy vite më parë.

Viktima Frrok Lleshaj

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

**Ora 22:32**

## Report Tv siguron FOTO-n e viktimës! Ish-polic tre dekada më parë, u largua më 1994! S'e pranoi asnjëherë vrasjen e kushëririt, hetohet në disa pista

Frrok Lleshaj, i vrarë sot në Vaun e Dejës

Report Tv ka siguruar foton e 65-vjeçarit të vrarë sot në Vaun e Dejës, ndërkohë që mësohen detaje të reja nga e shkuara e Frrok Lleshajt.

Viktima mësohet se tre dekada më parë ka ushtruar edhe detyrën e efektivit të Policisë së Shtetit, nga radhët e të cilës ka dalë në vitin 1994.

Më pas ka kryer një vrasje për të cilën u arrestua më 1995, por u arratis në vitin 1997 nga burgu gjatë traziravе.

Sipas të dhënave, mësohet se Lleshaj, u arrestua më vonë, ku vuajti dënimin e Gjykatës së Shkodrës të vitit 2006 dhe u lirua më 2023.

Nuk ka pranuar asnjëherë se ka qenë autor i vrasjes se kushëririt, por pavarësisht deklaratave ne Gjykatë, ai është dënuar.

Pista kryesore mbetet ajo e hakmarrjes, por Policia po heton në gjitha drejtimet e mundshme rreth dinamikës dhe shkaqeve. Hetohet edhe aktiviteti i tij pas lirimit nga burgu më 2023.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

**Ora 22:07**

## U ekzekutua sot në Vaun e Dejës, 65-vjeçari kishte vrarë kushëririn! Më 2006 u dënua me 25 vite burg, u lirua dy vite më parë

Policia e Shkodrës në vendngjarje

Frrok Lleshaj, 65 vjeç, sipas dosjes hetimore dhe vendimit të gjykatës, rezulton se ka vrarë kushëririn e tij Dodë Lleshaj më shumë se dy dekada më parë.

Për këtë krim ai ishte dënuar me 25 vite burgim, të cilin e kishte përfunduar vetëm dy vite më parë, duke u liruar në mesin e muajit prill 2023.

> *"Me vendim nr.37, datë 17.03.2006, të Gjykatës Shkodër, dënuar 25 vite burgim për vrasje me dashje dhe është liruar më datën 16.03.2023 nga IEVP Shkodër", thuhet në dosje.*

Lleshaj u gjet sot në mbrëmje i pajetë në rrugën e fshatit, teksa po ecte. Policia po vijon hetimet për zbardhjen e ngjarjes.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: vrasje fashiste Shkodër Vau i Dejës vrasje Policia e Shkodrës Frrok Ileshaj

Komentoj

**Komente**

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

**Sondazhi i ditës:**
Çfarë mendoni për ndryshimet e propozuara me draftin për Kodin e ri Penal?

3 Gusht, 06:37

Jam pro | Jam kundër | Nuk kam mendim

## Lajme të tjera

Shkodër/ Ndotja akustike, Policia aksion për matjen e nivelit të zhurmave dhe garantimin e qetësisë publike!
3 Gusht, 12:28

Rrezikuan jetën e pasuhasesve, policia bllokon 20 mjete lundruese nga Komani në Ksamil! Gjobiten me nga 1 mln lekë drejtuesit
3 Gusht, 12:16

Shkodër/ Asgjësohen 16 miijë e 755 bimë kanabis! Sekuestrohen edhe 320 kg dogë kanabisi me boçe, nuk dihen kultivuesit (VIDEO)
3 Gusht, 10:38

Shkodër/ Të shtëna në bjeshkët e Munellës! 37-vjeçari: Kemi konflikt me një bashkëfshatar, gjeta tabelë me mbishkrimin 'Ik se do vdesësh'! Policia gjen 6 gëzhoja
3 Gusht, 10:19

Pukë/ Dy turistet holandeze humbin rrugën në malet mbi Iqenin e Komanit, Policia i shpëton! Njëra ishte dëmtuar (VIDEO)
2 Gusht, 20:10

Ekskluzive/ 'Fshati turistik' pa leje në Thethi, i vetmi për të cilin prokuroria s'nisi hetimin! Për 6 muaj policia referoi 34 raste, akuza regjistroi 33

Sokol Dema

3 Gusht, 12:17

Rregullohen 17 kilometrat e para të Rrugës së Dukagjinit, nisin punimet në lotin e dytë Kir-Ndërlysaj (VIDEO)
2 Gusht, 11:43

Pas rikthimit në identitet të fshatit turistik, çifti lidh kurorë në Kishën e Thethit (VIDEO)
1 Gusht, 18:45

Bashkia Shkodër vëmendje të shtuar për institucionet kulturore, në rikonstruksion Teatri 'Migjeni' dhe Kinema 'Republika'

Ergys Kavaja

1 Gusht, 14:49

Shkodër/ Goditën me sende të forta dhe thikë 42-vjeçarin pas një sherri, pranga dy vëllezerve
1 Gusht, 11:01

E rëndë në Itali, 35-vjeçari vritet nga néna dhe partnerja! Policia gjen trupin në një kosh plehrash, e kishin mbuluar me gëlqere
1 Gusht, 10:43

Shkodër/ Plagosi me thikë një 42-vjeçar për motive të dobëta, policia arreston autorin (VIDEO)
31 Korrik, 18:51



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje